



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 381/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Klinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, për shkak të vendosjes së banorëve mbi rrugët publike, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Klinë kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 1650 (njëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

PZAP-i me datën 25. 10. 2013 ka pranuar një ankesë nga LVV-ja, në të cilën theksohet se me datën 29 tetor 2013 në hyrje të fshatit Volljakë të komunës së Klinës anëtarë të PDK –së kanë vendosur banerë të kandidatit për kryetar komune nga ky subjekt politik.

Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik PDK ka shkelur nenin 33 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografët nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, në pajtim me nenin 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, datën 30.10.2013 informoi subjektin politik PDK për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013, ora 12:00.

Me datën 31.10.2013 sipas afatit të paraparë PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë të pabaza dhe se sipas të dhënavë që kanë nga tereni fotot e deponuara nga LVV-ja janë të përsëritura dhe janë vetëm montime dhe se propozon që të shihen edhe ankesat e mëhershme të këtij subjekti politik me qëllim të vërtetimit rrithë vërtetimit të tyre se ku dhe kur janë bërë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesë është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se banerat dhe flamujt e subjektit politik PDK-së, ishin të vendosura mbi rrugët publike të

trafikut, veprime të cilat sipas dispozitave ligjore të LZP-së e bëjnë përgjegjëse subjektin politik PDK..

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, për këtë mori parasysh si rrrethanat rënduese ashtu edhe rrrethanat lehtësuese. Si rrrethanë rënduese mori se subjekti politik PDK edhe më parë ka kryer shkelje të natyrës së tillë dhe se konsiderohet si recidivist dhe si rrrethanë tjetër rënduese mori atë se subjekti politik PDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Prandaj vendosja e banorëve dhe të flamujve të saj mbi rrugët publike e bënë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrrethanë lehtësuese PZAP-i, mori parasysh faktin se PDK pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, në pajtim me nenin 32.6 të LZP-së ka ndërmarr veprime konkrete duke i larguar menjëherë banerat dhe flamujt e saj nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i duke i marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se subjekti politik PDK-së ka shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, me të cilat ndalohet vendosja e njoftimeve, pllakateve, posterave apo të slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në apo mbi rrugët publike.

Prandaj PZAP-i, në mbështetje të nenit 118.1 dhe nenit 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa**

Anr. 381/2013 më datën 01.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



**Këshillë juridike:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.